



Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRILSDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Nësisia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit (të Komunës)
Nr./Br./No 3215 Nr. i faq/Br.str/No.pg 93
Data/Datum/Date 27/12/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: 19- 23 DHJETOR 2022

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3180-2022
2.	Vendim për caktimin e Ekipit për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3181-2022
3.	Vendim për emërimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administrate, shëndetësi dhe Arsim për vitin 2023	NRP-02-3182-2022
4.	Vendim për ushtrimin e pozitës dhe detyrave të punës së zyrtarit për integritet evropiane	NRP-02-3183-2022
5.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3184-2022
6.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3185-2022
7.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3187-2022
8.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3188-2022
9.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3189-2022
10.	Vendim për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Auditim të Brendshëm të Komunës së Rahovecit	NRP-02-3191-2022
11.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-3194-2022
12.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3195-2022
13.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3196-2022
14.	Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2022	NRP-02-3197-2022
15.	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për cash plan	NRP-02-3199-2022
16.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-3200-2022
17.	Vendim për ndërrimin e pozicioneve në kontratë	NRP-02-3201-2022
18.	Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare	NRP-02-3209-2022
19.	Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare	NRP-02-3210-2022
20.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3211-2022
21.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3213-2022

Rahovec, dhjetor 2022





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES, REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVC, OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI I PRESIDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3180 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 29

Data/Datum/Date 19 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. Zekë Berisha nga fsh. Kramovik, Komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 5416, të dt. 9.12.2022 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Zekë Berisha, vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Zekë Berisha nga fsh. Kramovik,**
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESEDNIKA OPSTINE / MUNICIPALITY RAHOVEC
Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Pr./No. 3181 Nr. i faq./Br./str./No. pg. 89
Data/Datum/Date 19 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe nenit 70 paragrafi 70.20 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Ekipit për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. **Caktohet** Ekipi për Menaxhimin e Kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit - ritenderim" me numër të kontratës 623-22-6778-5-1-1/C445.
2. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës sipas piks 1 të këtij vendimi do të ketë këtë përbërje:
 - 2.1 Diellza Çanta – Udhëheqëse,
 - 2.2 Sokol Thaqi,
 - 2.3 Shpejtim Mustafa,
3. z. Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës ndërsa, z. Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike **CAKTOHET**, ndihmës/asistent i Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
4. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
5. Obligohen Ekipi për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës të hartojnë raport me shkrim në baza mujore për Kryetarin e Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Ekipi për Menaxhimin e Kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i prokurimit.
- DUPMM, dhe
- Arkivi

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVCIT / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES
Smajl Laçi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PRESSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 3182 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 82
Data/Datum/Date 19.12.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2023

1. Me këtë vendim **Emërohen** personat zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2023, në këtë përbërje:

1.1 Zyrtar/e Autorizues/se për listën e pagave:

- Afrim Limani- kryesor
- Besnik Hoti- zëvendës

1.2 Zyrtar/e Autorizues për paga në Shëndetësi:

- Saranda Sallteku – kryesor
- Elbunit Kryeziu – zëvendës

1.3 Zyrtar/e Autorizues për paga në Arsim:

- Avni Morina – kryesor
- Saranda Sallteku – zëvendës

1.4 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve:

- Perparim Krasniqi – kryesor
- Berat Duraku – zëvendës

1.5 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Shëndetësi:

- Saranda Sallteku – kryesor
- Elbunit Kryeziu – zëvendës

1.6 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Arsim:

- Avni Morina – kryesor
- Jeton Krasniqi – zëvendës

1.7 Zyrtar Autorizues për urdhër Blerje - proces order:

- Astrit Mullabazi – kryesor
- Kujtim Popaj – zëvendës

1.8 Zyrtar/e Zotues:

- Njomëza Fazliu – kryesore
- Ardian Rama – zëvendës

1.9 Zyrtar/e Certifikues:

- Esat Hoti - kryesor
- Ardian Rama - zëvendës

1.10 Zyrtar/e i Nënaloqimeve për Arsim:

- Lulzim Krasniqi – kryesore
- Bjondina Ramaj – zëvendëse

1.11 Zyrtar/e i Shpenzimeve:

- Zyber Thaqi - kryesor
- Egzon Thaqi - zëvendës

1.12 Zyrtar/e i Pranimeve:

- Ekrem Bytyqi- kryesor

1.13 Zyrtar/e autorizues të shpenzimeve për arsim (shkollat);

- Drejtorat e shkollave - kryesor
- Avni Morina - zëvendës
- Jeton Krasniqi - zëvendës

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Zyrtarët e emëruar,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyra e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No. 3183 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 90

Data/Datum/Date 20 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim z. **Alban Gashi**, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për barazi gjinore, pranë Drejtorisë për Administratë **autorizohet** që të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme në ushtrimin e pozitës dhe detyrave të punës, që dalin nga vendi i punës së Zyrtarit për integritet evropiane, pranë Drejtorisë për Administratë, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe zgjedhjes së Zyrtarit për integritet evropiane, sipas konkursit.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi do të kryej të gjitha funksionet të cilat dalin nga pozita e vendit të punës së Zyrtarit për integritet evropiane, pranë Drejtorisë për Administratë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset z. Alban Gashi dhe Drejtoria për Administratë në Komunën e Rahovecit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se Zyrtari për integritet evropiane, pranë Drejtorisë për Administratë, në bazë të konkursit është transferuar në vendin e ri të punës, vendi i punës së Zyrtarit për integritet evropiane, pranë Drejtorisë për Administratë është i lirë (vakant).

Për këtë arsye, duke marrë parasysh se kjo pozitë është e lirë për shkak të punësimit në një institucion tjetër publik në Republikën e Kosovës të zyrtarit për integritet evropiane ky vend është i lirë (vakant), pas administrimit të të gjitha provave u vendos që të autorizohet z. Alban Gashi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për barazi gjinore, që të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme në ushtrimin e pozitës dhe detyrave të punës, që dalin nga vendi i punës së Zyrtarit për integritet evropiane, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe zgjedhjes së Zyrtarit për integritet evropiane sipas konkursit.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Vendimi u dërgohet:

- z. **Alban Gashi**,
- **Drejtorisë për Administratë**,
- **Njesisë së Personelit, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No. 3184	Nr. i faq./Br./str./No. pg. 90
Data/Datum/Date 20/12/22	
Kryetari i Komunës / Mayor of the Municipality	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] me Nr. Protokolit 06-553/01-0053423/22, e dt. 6.12.2022 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] me datë 6.12.2022 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 30.11.2022 ka lindur vajzë në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./Br. No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br. No. 3185 Nr. i faq./Br. str./No. pg. 90
Data/Datum/Date 20/12/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] dhe me vendbanim në Rahovec me Nr. Protokolit 06-553/01-0054188/22, e dt. 12.12.2022 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] me datë 12.12.2022 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 10.12.2022 ka lindur djalë në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3027 Nr. i faq./Br.str./No.pg 32

Data/Datum/Date 20 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted], Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolit 5501, të dt. 19.12.2022 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katërqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted] e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT / KABINETI I PRESIDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No. 3188 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 90
Data/Datum/Date 20.12.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] Komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 5437, të dt. 12.12.2022 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katërqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes së vëllaut.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit dhe do të transferohen në [redacted]
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së vëllaut, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVOS / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësi: Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3189 Nr. i faq./Br.str./No.pg 30

Data/Datum/Date 20/12/22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolit 5436, të dt. 12.12.2022 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted], e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3191 Nr. i faq/Br.str/No.pg 92
Data/Datum/Date 20 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008"), nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 3/2018"), Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, nenit 5 të Rregullores Nr. 34/2021 për pagesën e pagave dhe shtesave të kryetarëve/kryesuesve dhe të anëtarëve të bordit për rishqyrtimin e ankesave, komiteve të auditimit, këshillit kosovar për raportim financiar, Qarkores për Organizatat Buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me Nr. Prot. 513/2022 të datës 22.03.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Auditim të Brendshëm të Komunës së Rahovecit

1. **Emërohen** anëtarët e Komitetit për Auditim të Brendshëm në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Sead Boshnjaku, kryesues
 - 1.2 Afërdita Zena, anëtare
 - 1.3 Blerina Kabashi, anëtare
 - 1.4 Mirsad Shala, anëtar
 - 1.5 Skender Hamza, anëtar
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Auditim të Brendshëm janë të përcaktuara në Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike Nr. 06/L-021 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik.
3. Komiteti i Auditimit do të ndihmojë udhëheqësin e subjektit të sektorit publik në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, që të ofrojë këshilla dhe rekomandime për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm, ta mbështesë Njësinë e Auditimit të Brendshëm për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet e menaxherëve të cilët auditohen, etj.
4. Kompenzimi për anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm do të jetë **120€ (njëqind e njëzet euro)** për kryesuesin e komitetit dhe nga **100€ (njëqind euro)** për anëtarët e komitetit, për çdo takim të mbajtur sipas nenit 5 të Rregullores Nr. 34/2021 për pagesën e pagave dhe shtesave të kryetarëve/kryesuesve dhe të anëtarëve të bordit për rishqyrtimin e ankesave, komiteve të auditimit, këshillit kosovar për raportim financiar dhe Qarkores për Organizatat Buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me Nr. Prot. 513/2022 të datës 22.03.2022.

5. Mjetet për pagesën e anëtarëve nga pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 do të bëhet nga kodi Mallra dhe Shërbime ndërsa pagesa e anëtarëve nga pika 1.4 dhe 1.5 do të bëhet nga kodi Paga dhe Mëditje.
6. Mandati i Komitetit për Auditim të Brendshëm është tre (3) vjeçar.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komitetit për Auditim të Brendshëm, Njësia për Auditim të Brendshëm dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komitetit,*
- *Njesisë për Auditimit të Brendshëm,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për qasje në dokumente publike

1. Miratohet si e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 3152, e datës: 14.12.2022 për qasje në dokumente publike nga Egzon Dahsyla, gazetar në BIRN/KALLXO.com dhe i ofrohet qasje e **lejuar** për listën e mediave/kompanive mediale dhe të ofrohen informatat si në vijim:
 - 1.1.Listën e mediave dhe kompanive mediale, që iu kanë ofruar shërbime të marketingut, periudha 2001-2022.
 - 1.2.Listën e mediave dhe kompanive mediale që iu kanë ofruar shërbime të transmetimit, periudha 2001-2022.
 - 1.3.Kontratat e nënshkruara me secilën prej mediave/kompanive mediale.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

3. Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 3152, e datës: 14.12.2022 për qasje në dokumente publike nga Egzon Dahsyla, gazetar në BIRN/KALLXO.com dhe i ofrohet qasje e **plotë** në kontratën listën e mediave/kompanive mediale dhe të ofrohen informatat si në vijim:
 - 3.1.Listën e mediave dhe kompanive mediale, që iu kanë ofruar shërbime të marketingut, periudha 2001-2022.
 - 3.2.Listën e mediave dhe kompanive mediale që iu kanë ofruar shërbime të transmetimit, periudha 2001-2022.
 - 3.3.Kontratat e nënshkruara me secilën prej mediave/kompanive mediale.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë **ELEKTRONIKE**.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Blerta Gashi**, zyrtares për shqyrtimin fillestar të QDP,
- **Egzon Dahsyla**, BIRN/KALLXO.COM, parashtrues i kërkesës dhe
- **Arkivit**.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No. 3195 Nr. i faq./Br.str./No.pg 91

Data/Date/Date 20 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve" me numër të kontratës 623-21-4434-5-2-1/C294 si në vijim:
 - 1.1 z. Arbnor Kabashi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi, pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Afrim Oruqi, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/1630/22 i datës 3.3.2022
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.


Smail Latifi
Kryetari i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I Kryetarit të Komunës/KABINETI PRESIDENJA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Lidhja Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Dr./No 3196 Nr. i faq./Br.sht./No.pg 91

Data/Datum/Date 20 / 12 / 22

RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 të nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Shërbimet e transmetimit të Kuvendit dhe shërbime të tjera për Komunën e Rahovecit" me numër të kontratës 623-22-11551-2-2-1/C449, si në vijim:
 - 1.1 z. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Afrim Limani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i prokurimit.
- Drejtoria për Administratë, dhe
- Arkivi



Sinaj Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Kryetari i Komunës (Kryetari i Kryetarit të Komunës)
Nr. 3197 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 90
Data/Date/Date 20.12.22
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 22 paragrafit 1 pika 1.2 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve të Komunës së Rahovecit, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2022

1. **Caktohet komisioni për përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2022 në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Muharem Morina, kryesues
 - 1.2 Vlora Sylaj - Reshiti, anëtare
 - 1.3 Shaip Shala, anëtar
 - 1.4 Nadir Sulejmani, anëtar
 - 1.5 Taulant Haxhimustafa, anëtar
 - 1.6 Arbnora Sokoli, anëtare
 - 1.7 Lulzim Kadiri, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e laureatëve të sportit për vitin 2022, të shpërndajë mirënjohje, të ndërmarë të gjitha veprimet organizative për mbarrëvajtjen e ceremonisë për ndarjen e çmimeve për sportistët e dalluar, të shpërndajë ftesat për individë dhe grupe të rëndësishme për pjesëmarrje në ceremoni.
3. Obligohen komisioni që të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
4. Komisioni është i obliguar që të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe DKRS-në mbi ecurinë, mbarrëvajtjen dhe shpenzimet e ceremonisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DKRS, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT E RAHOVECIT / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësi Nr./Br./No. (Sëbagjësi i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 3199 Nr. i faq./Br.str./No.pg 91
Data/Datimi/Date 20 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit përgjegjës për cash plan

1. **z. Pajtim Haxhijaha**, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për arkiv, pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET**:

1.1. Zyrtar përgjegjës për cash plan.

2. Obligohet z. Pajtim Haxhijaha që të veproj duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset i lartpërmenduri dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Vendimi prodhon efekt juridik deri në marrjen e një vendimi tjetër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- **z. Pajtim Haxhijaha,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 3200 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 91
Data/Datum/Date 21/12/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për qasje në dokumente publike

1. Miratohet si e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 3193, e datës: 20.12.2022 për qasje në dokumente publike nga Bekim Salihu, hulumtues në Institutin GAP dhe i ofrohet qasje e **lejuar** për shërbimet administrative në nivel lokal dhe të ofrohen informatat si në vijim:
 - 1.1 Sa është numri i zyrtarëve të angazhuar në komunën e juaj në zyrën e ofiqarisë?
 - 1.2 Sa shpenzon komuna në vit për pagat e të punësuarve në zyrën e ofiqarisë?
 - 1.3 Sa dokumente të gjendjes civile lëshohen brenda vitit nga zyret e ofiqarisë sipas natyrës së dokumenteve?
 - 1.4 Sa janë të hyrat vjetore të komunës të gjeneruara nga lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile?
 - 1.5 Sa dokumente të gjendjes civile janë lëshuar nga platforma E-Kosova që i përkasin komunës së juaj, nga koha kur është ofruar si mundësi tërheqja e disa dokumenteve nga kjo platformë?
 - 1.6 A ka ndonjë platformë digjitale që e ka në përdorim komuna juaj në çfarëdo sektori (shëndetësi, arsim, kulturë, administratë)?
 - 1.7 Sa janë shpenzimet vjetore të komunës për materialet dhe mallrat e përdorura për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile? (përfshi këtu shpenzimet për letrat në të cilat printohen dokumentet sikurse certifikatat, tonerët e printerëve, blerjen e printerëve, kompjuterëve etj.)
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 3193, e datës: 20.12.2022 për qasje në dokumente publike nga Bekim Salihu, hulumtues në Institutin GAP dhe i ofrohet qasje e **plotë** në shërbimet administrative në nivel lokal të cekura në pikën 1 të vendimit.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë **ELEKTRONIKE**.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- *Blerta Gashi, zyrtares për shqyrtimin fillestar të QDP,*
- *Bekim Salihu, hulumtues në Institutin GAP, parashtrues i kërkesës dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3201 Nr. i faq/Br.str/No.pg 91

Data/Datum/Date 21 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull "Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë" me Nr. të Prokurimit 623-21-1191-5-2-1, Kërkesës së menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 5490 të datës 16.12.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin e pozicioneve në kontratë

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë" me Nr. të Prokurimit 623-21-1191-5-2-1, pa implikime financiare.
2. Ndërrimi i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicionet 3.1, 3.12, 3.13, 3.14, 3.16, 6 dhe 1.9 në pozicionet e domosdoshme për realizim 2.8, 2.10, 2.11, 2.12, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7 dhe 3.8.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Projektit dhe Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me datë: 16.12.2022 kemi pranuar kërkesën nga Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtëpërdrejt i kontratës, për ndryshim të pozicioneve në kontratën me titull "Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë" me Nr. të Prokurimit 623-21-1191-5-2-1, pa implikime financiare.

Ndërrimi i pozicioneve në këtë kontratë do të bëhet nga pozicionet 3.1, 3.12, 3.13, 3.14, 3.16, 6 dhe 1.9 në pozicionet e domosdoshme për realizim 2.8, 2.10, 2.11, 2.12, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7 dhe 3.8 në shumën e përgjithshme prej 3,423.18€ (tremijë e katërqind e njëzet e tre euro e tetëmbëdhjetë cent).

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit dhe dikasteret e tjera, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Menaxherit të kontratës,
- Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Njësisë së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetari të Komunës)

Nr./Br./No 3209 Nr. i faq./Br. str./No pg 92

Data/Datum/Date 22 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Konkursit të rishpallur të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 148 të datës 21.11.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ekzekutimin e mjeteve financiare

1. Me këtë vendim lejohet ekzekutimi i mjeteve financiare në shumën prej **1,864.26€ (një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e njëzet e gjashtë cent)** për z. Bedri Hoti nga fsh. Ratkoc, Komuna e Rahovecit, fitues i projektit për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit.
2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.05.2022, ka spallur konkurs për dizajnimin e këtyre çmimeve, të cilat janë të parapara me këtë rregullore.

Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit në konkursin e rishpallur nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport me Nr. Prot. 148 të datës 21.11.2022, si dhe vlerësimit të jurisë profesionale, z. Bedri Hoti është shpallur fitues për dizajnimin e Dekorates "Qytetar Nderi i Komunës së Rahovecit", Dekorates "Nderi i Komunës së Rahovecit", Dekorates për Humanizëm "Ali Sokoli", Çmimi "Bujku i Vitit", Çmimi "Lexuesi i vitit" dhe Medales "Sportisti i vitit".

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Z. Bedri Hoti nga fsh. Ratkoc,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PRESIDENTIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 32/0 Nr. i faq./Br.str./No.pg 92
Data/Datum/Date 22 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Konkursit të rishpallur të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 148 të datës 21.11.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për ekzekutimin e mjeteve financiare

1. Me këtë vendim lejohet ekzekutimi i mjeteve financiare në shumën prej **1,135.74€ (njëmijë e njëqind e tridhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë e katër cent)** për z. Fehmi Hoxha nga Rahoveci, fitues i projektit për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit.
2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.05.2022, ka spallur konkurs për dizajnimin e këtyre çmimeve, të cilat janë të paraparë me këtë rregullore.

Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit në konkursin e rishpallur nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport me Nr. Prot. 148 të datës 21.11.2022, si dhe vlerësimit të jurisë profesionale, z. Fehmi Hoxha është shpallur fitues për dizajnimin e Dekoratës "Ukshin Hoti", Medalja e Lirisë, Çmimi Letrar "Sulejman Krasniqi", Çmimi "Artisti i vitit", Mirënjohje dhe Falenderime.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Z. Fehmi Hoxha nga Rahoveci,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësi Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3211 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 92

Data/Datum/Date: 22 / 12 / 22

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Mirëmbajtja dhe pastrimi i Palestrës Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec" me numër të kontratës 623-22-12829-2-2-1/C451 si në vijim:
 - 1.1 z. Muharem Morina, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për rini, pranë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Afrim Dina, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi.


Smajl Lafi
Kryetari i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Pr.Nr. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës	
Nr./Pr.Nr. 3213	Nr. i faq. Br.shr./No pg. 93
Data/Date/Date 23 / 12 / 22	
Bashkëpunëtor / Co-ordinator	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Instalimi i ngrohjes qendrore në bibliotekën e qytetit dhe shtëpinë e kulturës në Rahovec" me numër të kontratës 623-22-8319-5-2-1/C452, si në vijim:
 - 1.1 znjsh. Diellza Çanta, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për eficiencë të energjisë, pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** menaxhere e Kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Afrim Dina, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi.

